

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligji Nr. 08/L-332 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 neni 9 paragrafi 6 dhe 7, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën **29.05.2025** miratoi këtë:

V E N D I M

(Për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim në vitin 2025, në shumën 194,930.63€)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi më Nr.04-400/01-0017493/25, i datës 13.05.2025, Për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim në vitin 2025, në shumën **194,930.63 €**, ku në shumë prej **52,748.53 €** mjete të pa shpenzuara, ndërsa tejkalimi nga realizimi i THV në shumë prej **142,182.10 €**.

Neni 2

Mjetet-e cekura në nenin 1 të këtij vendimi, bartën në kategorinë e shpenzimeve si në vijim:

- Ne kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 92,002.99€;

Në nën programin Shërbimet e shëndetësisë primare 74400 kodi funksional 0721, shuma 40,000.00 €,

Në nën-programin Arsimi parashkollor 92650, kodi funksional 0911, shuma prej 30,000.00€,

Në nën-programin Infrastruktura rrugore 18023, kodi funksional 0451, shuma prej 22,002.99€.

Shuma nga tejkalimi planit nga THV ne kategorinë mallra dhe shërbime është 62,038.40 €.

- Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transferove shuma prej 30,000.00€;

Në nën-programin Planifikim i zhvillimit ekonomik 48023, kodi funksional 0411, shuma 30,000.00€,

Shuma nga tejkalimi planit nga THV ne kategorinë subvencione dhe transfere është 21,684.52 €.

- Në kategorinë e shpenzimeve kapitale shuma prej 72,927.64€;

Në nën-programin Planifikimi mjedisor dhe inspeksioni 66620, kodi funksional 0620 projektin si vijon:

"Vazhdimi i punimeve te kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së" kodi i projektit 52641, shuma 72,927.64€.

Shuma nga tejkalimi planit nga THV ne kategorinë shpenzime kapitale është 58,459.18 €.

ARSYTIM: Kategoria e mallrave dhe shërbime; Bartja e mjeteve në këtë kategori është me se e domosdoshme për shkak të obligimeve të cilat janë në vazhdimësi sidomos të sigurimi i barnave esenciale, shërbimet e nevojshme në zona rurale, arsim para fillor të i cili janë furnizimet për fëmijët parashkollor me artikuj të nevojshme, furnizimet me material higjenik në arsimin fillor, shërbime tjera të kontraktuara nga shërbimet publike, të gjitha programet janë reduktuar nga këto vendime me çka është rrëzuar edhe mbulimi i shpenzimeve operative me buxhetin e vitit 2025.

Kategoria e subvencioneve dhe transferove; Realizim i vendimit të asamblesë komunale i datës 03.03.2025, me Nr.01-400/01-008611/25, për mbështetje financiare të “Eko Natyrës” Sh.A. Skenderaj për ngritjen e kapaciteteve dhe zgjerimin e shërbimeve.

Kategoria e shpenzimeve kapitale; Bartja e mjeteve për projektin e lartcekur në programin përkatës është obligim sipas kontratës dhe aneks kontratës dhe me këtë bartje të mjeteve përfundon edhe realizimi i këtij projekti.

Neni 3

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë; Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrje të Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 30 dita nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e komunës.

Vendimi i Dërgohet :

1x1 Arkivit,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 DBF-së,
1x1 MAPL-së
1x1 MF-it,
1x1 Dosjes.

KRYESUESJA E KUVENDIT

znj. Adelina Spahi

